

FATMIR R. GJATA
ME DHEUN TIM I DASHURUAR...
POEZI

BOTIMET TOENA

FATMIR R. GJATA

ME DHEUN TIM I DASHURUAR...

poezi

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2019

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Redaktor: Kujtim Dashi

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike dhe kopertina: Elsa Hajderaj

ISBN 978-9928-277-36-7

© Autori

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti apo forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjolllesha", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116

Email: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

www.toena.com.al

Për Kitin dhe Evin.

Mall

E ka një mall në zemrën time, më lind e rritet si një pishë,
me rrënjë të hapur kraharorit, kurora rritet drejt në mish
e del shpërthen në dritë të diellit, në dritë hëne zë lëngon
e ka një mall në zemrën time, malli u bë mal... u bë jehonë
e lumë u bë ku ujët mblidhet e del shpërthen nga shtrat i qetë,
pastaj shkon detesh të panjohur deri sa bëhet bashkë me retë
derisa shkon në fund të botës e kthehet prap' ku ish më parë.
E kam një mall në zemrën time që trupin... trupin ma ka vrarë,
dhe ma lë shpirtin trazuar, nëpër ca ëndrra vjen mbështjellë
lind e rritet si një pemë që s'dita kurrë kush e kish mbjellë...

Vaje

E qajnë ca plaka faqeçjerrë, e qajnë ca të rinj gjer në mesnatë,
lajnë me lot ca gurë të bardhë... iku i shkreti s'pati fat
e vënë ca lule prej plastike të blera tregut plot pluhur,
t'i bëjmë një lapidar të madh, nuk është këtu vendi i duhur
e heshtin pranë një gotë rakie, e heshtin gjatë për të harruar
e qan një babë vetullngrysur, e qan një vajzë e dashuruar,
gjersa dhe koha lan të gjitha, fshin e çngjyros çka ishte gjallë,
aq tinëzisht e mbrapa krahësh, se nuk ia del dot ballë për ballë
e mbeten zogjtë nëpër foleza, mbi tokë ndriçon pakëz fosfor
e qajnë ca plaka faqeçjerra, e qajnë me shami në dorë,
përballë gurësh të paemër, gerrat u shlyen një nga një
e bie mbrëmja mbi varreza, e nuk dëgjohet asgjë,
dhe gulç i ngjirur mori fund, nesër fillon një ditë tjetër,
në gropë të hapur ca pika shiu, ca pika loti përmbi mbi letër...

Me tokën time flas

Në dheun tënd s'bëhesh dot profet, e shumta bëhesh këngëtar,
të gjithë kujtojnë fëmijërinë e vogël kur bredh i zbathur në ugar
e të kujtojnë këmbët me baltë, me baltë gri të vendit tënd,
ndaj s'dua kurrë të bëj profet, atje ku plepat mbajnë mend,
atje ku zogjtë rënë nga foleja, më lanë një degë të cicërija,
atje ku hënëz mbas mesnatës, më çonte deri te shtëpia
e pastaj shkonte thellë detit, e s'dita kurrë ku kishte rënë,
çfarë dreq profeti quaj veten, çfarë dreq profeti paskam qenë,
kur s'dita as të hapja krahët, mbi një kodrinë të fluturoj,
pastaj të flisja me kallinjtë, me çfarë në jetë dashuroj,
të flas me baltën plasaritur nga ç'dhimbje pa edhe dëgjoi,
pa qenë profet në tokën time, me tokën time flas me gojë...

Toka ime

E klithmë del nga gjoks i shqyer kur këmba shkel në dheun gri
e si nuk flas një fjalë të vetme derisa futem në shtëpi,
vetëm shikoj i batërdisur përreth ku ishte një sinor
e mallin pak shpërndaj me sy, e mallin pak shpërndaj me dorë
e marr me vrap çdo rrugë të njohur, çdo rrugë panjohur marr me
vrap,

ku mbase gjallë do vij në fund, a ndoshta vdekur kthehem prapë,
nën trëndafila të gjysmuar, gonxheshpërthyer mbushur vesë,
në fushë të gjerë e pambarim, në t'ëmbël fushë të Myzeqesë,
atje ku kodrat bëjnë kufirin, ku bën kufi një det me shkumë
e mespërmes të tre lumenjve, nga trup më rrjedh tjetër lumë,
më rrjedh klithmë nga gjoks i hapur, më rrjedh llavë e pashuar
e gjak më rrjedh nga plagë e kuqe, nga trëndafil i lulëzuar
e nga një gonxhe marr pak shpirt, nga kripë e bardhë marr pak jetë,
një zë i ngrohtë më tregon trokthin e më tregon rrugën e fshehtë,
ku mund të eci me sy të mbyllur, se sytë nuk m'u dashkan më
e nis e shkruaj varg mbas vargu, një këngë këndoj ashtu nën zë,
mbi brigjet e të tre lumenjve hedh dhe një valle amshuar,
aty ku linda e do vdes, me dheun tim i dashuruar...

Shtëpia ime

Shtëpia ime është midis lumenjve të ngrohtë
kryqëzuar mbi barqe ranishtash të pafund,
thurur me pendë të humbura rosakësh të zhurmshëm,
thurur me pëshpërima të rëna mes gishtash,
aty midis mollëzave, që shënojnë identitetin.
Çfarë ngjyre kanë sot dritaret... i kam harruar
duke ndërruar qiejt me shpejtësi të rrëmujshe,
duke i lënë përdhe e duke i shkelur me këpucë të lerosur.
Copëza xhami më presin akoma për të më parë gjakun,
aty, aty midis lumenjve të mi, Gjanicës, Semanit e Vjosës.

Shtëpia ime, trari i rëndë i çatisë, tjegullat e pjekura
i mbart mbi shpinë e i rrëzoj, i ringre çdo ditë,
në fjalët që kurrë s'ia thashë ndaj zbehem para dashurive,
në të pastajmen e shuar në qetësi të tërbuar kohërash,
duke kërkuar emrin e pagëzimit vënë gjatë natës.

E ç'mbeti i lashë, klithmat me lot, lotët me baltë,
vijat nëpër faqe ç'u rreshkën në diell duke notuar
djersën në shpinën e Kazilit shpuar me hosten të gjatë,
uahaaa jetë, uahaaa Kazil, ikim, ikim tek pus i bekuar,
ku është akoma kova e ndryshkur për kë akoma ka etje.

E mbledh akoma pikat e fundit të ujit të kripur,
vadis qiparisat e lënë në mëshirë të fatit dhe unë
rrugët vadis, që mos të ngrihet më pluhur i verdhë,
pastaj rehatohem mes degëve të jeshilshme çdo stinë,
mes lumenjve që sjellin lajme nga larg e nga afër...

Më jep llahutkë e violinë

Më jep llahutkë e violinë, më jep një harmonikë të grisur
e një gërnetë për të zinë, të kthehem prapë ku isha nisur,
edhe një def prej arixhiu që të këndoj gjer në të gdhirë,
edhe mezenë me gjithë rakinë, t'i çohem valles tapë i pirë,
ashtu i pirë me musht jete, në kohë që mushti u thartua
e të këndoj vetëm për vete, e t'i them botës se sa të dua
e të përkundem në një ëndërr, në kohë kur ëndrra s'ka më kush,
të ngjitem lart gjirit tënd gjersa të vete poshtë në fushë,
gjersa të gjej tingujt e duhur edhe të dehem me muzikë,
me një llahutkë të përharuar, me një të grisur harmonikë...

Atje ku linda

Atje ku linda, atje ku vdiqa... e ku jetova dashuri,
atje ku putha babëzitur, atje ku kurrë s'më pa njeri,
atje ku lashë veç hijen time edhe s'e mora mbrapa më,
atje ku bëra një folezë edhe u fsheha pa bërë zë,
atje në gjirin qumështuar ku rridhte pak veç për mua,
atje me flokët i mbuluar duke të thënë sa shumë të dua.
Me fshamat dalë nga brendësia sikur nga brenda ishe tharë,
ku mish e shpirt ishin bërë bashkë e s'kishte më për të marrë
e s'kishte më për të dhuruar, sepse dhuratë ishim bërë,
në ishim dy në kohë të vjetër tani u bëmë një i tërë...

Një kallëz grurë

Një kallëz grurë, shkoqa në duar, një kallëz grurë
e blova miell, mbushur me hime, përmbi një gur
e lashë foleza, për dallëndyshet, që s'erdhën më,
në një çatizë, tjegullçngjyrosur, pa tjetër gjë.
E fluturova krahëhapur, arash të mbjella, ëndërruar
të kisha thënë, që do të vija, kisha premtuar,
me fije bari, mbledhur në sqep, zog i papendë,
me krahë të hapur, me sy të lagur, me ty ndër mend,
herë shtegtuar, në vend të largët, e herë aty,
të të përqafoj, të mbaj në gji, të shoh me sy,
në dhimbje moti, kur bënte ftohtë a vapë e gjallë
e ndjeva diellin, kur ndizej shpejt, mbushur me mall.

Rruga e kthimit

E ëmbël është rruga e kthimit
pa masë të vetëdijshme, pa kilometra e metra,
vetëm gurë të shkërmoqur kthen në pluhur,
vetëm pluhur i kthyer në baltë
e baltë e avulluar ngadalë shtegton.

Dhe fus duart i përziej, e i largoj nga çatitë e kuqe,
u vë zogjve nga një copëz reje mbi shpinë
zogjve, që ngjërojnë ujë të kripur
duke lënë shkrime të çuditshme atje ku kalojnë,
duke matur trëndafilin e erërave.

I ëmbël është kthimi vetë,
zhurma e një lese, që hapet pa e shtyrë,
kuisja e një kove, që zbret e ngjitet në pusin e thellë,
ku hidheshin vajzat e pafata në dashuri
dhe shikonin për herë të fundit një unazë qielli.

U rritëm bashkë, unë brenda teje e ti në mua,
aq sa s'mundem dot më të të mbaj në gji
e kthehem për të zbrazur gjithçka që më rëndon
e të nis të rimbushem edhe njëherë nga e para,
me Myzeqenë time të grurosur.

Dhe djepin e kalbur rimbush me të qara fëmije,
ato të qara që s'munda njëherë e një kohë,
ngaqë duhet të rritesha shumë shpejt,
ngaqë duhet të ikja shumë shpejt,
për të ndier më rëndë peshën e kthimit...

Myzeqe

Si ika vallë, dreqi më marrtë,
si s'pashë akoma, vigjer¹ të lartë
kur dhe një ditë, më duket pak,
pa hipur më, në ato kavakë,
me fole zogjsh, përtokë rrëzuar
atë fushë të bukur, të bekuar
e kishte parë edhe syri i Zotit,
duke kënduar pikën e lotit.
Si munda vallë, si s'm'u tha këmba,
si bimë e gjelbër tharë nga brenda,
si s'm'u tha syri kur ika larg,
si një poet që vjedh një varg,
që vjedh një hënë kur ka një yll,
kur vjedh një dru kur ka një pyll.
Si munda larg të rri kaq kohë,
si bëra vetëm kur gjë s'më ngroh,
në dhë të huaj, s'është dheu im,
është veç ofshamë e psherëtimë,
është veç një varr ku vdes ngadalë,

¹ Pishë e lartë.

pa ndier gjë, pa thënë një fjalë
si munda vallë të lija ty,
me dhé të bardhë, me dhé të zi,
si s'më dha Zoti një forcë të madhe,
që të shëtisja ato livadhe,
ato burime që më bënë burrë,
at' fushë të gjerë që s'harroj kurrë.
Do kthehem prapë do vij tek ti,
me djersë në trup si në magji
të të përqafoj e puth ngadalë,
çdo cep ugari me mallin mal,
me mallin që më sjell aty,
me dritë në zemër, me dritë në sy.

Valle myzeqare

Hidhe moj hidhe, pak këmbën,
të puth buzë moj të ëmbël,
o po loze dorën, moj dorënë
dorën e vogël moj edhe belinë.

Hidhe moj këmbën, me ngadalë
të t'i them o moj dy-tri fjalë
e dy-tri fjalë moj të bukura,
o po sa të dua meskëputura.

O po sa të dua moj fluturzë,
ç'ma këpute moj shpirtin,
o po ç'ma këpute moj shpirtin,
o po se ç'ma plase moj zemrën.

E po hidhe, hidhe pak vallenë
e më jep dorën moj dorënë,
të të vë zinxhirë moj të bukurë,
me shumë rruaza moj gushesë.
Një lule të bukur moj të vura në flokë,
herë një trëndafil e herë borzilok,
e po borzilok moj me erë të mirë,
hedhim vallen gjer në të gdhirë.

O po në të gdhirë moj me dritëzë,
do të marr moj e të shkoj të flë,
e po do të flë moj e të mbaj në gji,
o po leshraverdha moj ngjyrë flori.

Jam myzeqar në Shqipëri

Jam myzeqar në Shqipëri, në Fier jam nga fushëkriposur
e shqiptar jam andej jashtë, i gjallë nuk jam, as i varrosur,
i ardhur jam në fshatin tim, vij nga një arë me pus të thellë,
një copëz dhé i prerë në mes, një copëz dhé i sapombjellë,
i sapokorrur kallëza shpërndarë, ku gruri mbillet vetvetiu,
harroj dhe veten ndonjëherë, harroj dhe veten unë i ziu,
harroj dhe këngët që këndova, ndaj nis e bëj këngë të reja,
çfarë humba ditën që ika larg, e s'munda kurrë më të të gjeja
e s'munda kurrë të fluturoja, mbi krifa kuajsh në kënetë,
ndaj zogth i vockël pak u bëra, ndaj kalë i zi u bëra vetë,
edhe vrapova drejt me trok, trokthit vrapova nën një hënë,
se shpirt më ishte përvëluar, se shpirt i gjallë më ishte ngrënë
dhe trupi m'u kalb ashtu papritur, sikur nuk isha më njeri,
në Fier jam nga fushë e bardhë, jam myzeqar në Shqipëri...

Ndërmenas

Numërova degë marinash e tufa zhuke, pllakëza dheu të çara,
grimëza rëre të mbuluara nga kripa me thërmija të bardha,
lumenjtë e kanalet e gjolet e lerat e rrekëzat e ujit me pika,
një për një e tufë për tufë e bulëz për bulëz kur ika,
ishin krahët e mi, krahët e tu, krahët e atyre që s'janë më,
trupi im është, ai për të cilin s'kam nevojë, nuk vlen asgjë
arteriet e mia të mbledhura grusht e të hedhura më tutje,
atje ku gjyshja ime e mirë i mblidhte duke mërmërirë lutje,
pastaj këndonte në dasma që s'mbaruan kurrë në kohë të duhur,
me dasmorë të dehur nga një gotë raki e një gotë pluhur,
duke u lëkundur në qerret me rrota të mëdha në kthim,
në rrugë që s'kishin të sosur, në rrugë që s'kishin mbarim.

I bukur është kthimi mbas dehjes e qetë shkojnë ngadalë,
ugareve me emra të vdekurish që nuk thonë një fjalë,
pusesh me kovë të ndryshkur, me kovë të ndryshkur në diell
e s'ka më litar, litari u tret në baltë, balta u tret në qiell,
edhe dielli vetë u tha në një takije të zhulosur mbi kokë,
në pritje të një reje të zezë apo të bardhë të zbriste mbi tokë,
derisa s'm'u desh t'i numëroja edhe harrova numrat e shkruar,
se s'kish më varre të vjetra ku mund të shtrihesha i qetuar,
s'kish zogj të ndjekur nga hëna e hijen e tyre nuk e pashë më,
as përrallën e një plaku qorr që duke treguar mbet pa zë,
nën trungun e një peme ku mbinin filiza të magjishme
duke gënjyer stinët e tyre në mënyrë të perëndishme...

E me një frymë

E me një frymë e piva mallin, e mallin piva me një frymë,
gjoksit m'u ndez një shkëndijë e nxori flakë e nxori tym
e ca thëngjij mblodha në tokë, mbi dhé të zi mblodha thëngjij,
u plaka në një çast të vetëm edhe rilinda si fëmijë,
nga mall që bridhte si një kalë që frerët kurrë s'i kishte parë,
pa ditur ku e kisha zemrën, se zemrën... zemrën ma ke marrë
e ma ke çuar andej tutje ku dielli lind me tërsëllimë,
andej ku është vend' që më lindi, andej ku është vendi im,
ku rrjedhin që të gjithë lumenjtë, e derdhen që të tre në det,
ashtu si gjak' më rrjedh ndër deje ashtu siç gjaku nuk u tret
e pakëz ujë e mbaj për vete, mbush edhe zbraz në një gotë
e gjysmë bosh e piva mallin, e mallin piva gjysmë plot..

Avull mbi rrugë

Avull mbi rrugë, me erë bari, korrur sërish,
përzier frymë, dalë e mbledhur, gjersa të vish,
gjersa të vij, mbi rrugë drite, çarë e stërfarë
mbi mall të dhënë aq papritur, mbi mall të marrë,
mbi mall të çartur ku thur kurorë me luledielli
lindje-perëndim, perëndim e lindje, ku është qielli
të na mbulojë me dritë shumë, me yje shumë në errësirë,
avull mbi rrugë, frymë e lëshuar gjer në të gdhirë
gjer në mëngjesin që s'ish mëngjes, por lindje tjetër,
ku mbinë ca lule me tjetër ngjyrë mbi rrënjë të vjetër,
ku mbinë të dua, ndier gjer në shpirt të dëshpëruar,
avull mbi trup të drobolisur, një çast përjetë dashuruar...

Baltë e Myzeqesë

Thahet edhe ndahet, shtyhet edhe ngjyhet, plasur edhe ngjasur,
rreshkur edhe pjekur, tharë cingërueshëm, lëkurëargasur,
në ligj të natyrës, në erë edhe zjarr, të mbetur mbi tokë,
mbi tokë edhe qiell, me tokë nën këmbë, e qiell mbi kokë,
me ujë edhe pluhur, me pluhur dhe ujë, rënë edhe ngjitur,
përzier me gjak, mpiksur nëpër rrjedha, shkuar babëzitur,
stolisur me mall, me diell të nxehtë, që kurrë s'perëndon,
në fushë të grurosur, e kthyer në ar, shkrirë ku buron,
ku burojnë hareshëm, bulëza me kripë, shtrirë në pëllëmbë,
thahet edhe njomet, në cikël rrethor, mbetur nën këmbë,
mbetur përmbi flokë, në kryqe të zbritur, mbi shtëpinë time,
baltë e Myzeqesë, o e ëmbla baltë, bukë edhe thërime...

Berat

Një mbi një, nënë kështjellë, një mijë e një dritare,
një mijë përralla të pambaruara, pa nisur fare,
ëndrra një mijë, vëna në radhë nën njëra-tjetrën,
natëditë e re, në luftë të gjatë e mund të vjetrën.
Mes të përrallës i mbyll pak sytë e pak të shoh,
si nuk të ndjeva, si nuk të mora, si nuk të njoh,
si s'të dëgjova hapin sokakësh me gurë gri,
si nuk bërtita me zë të lartë kur s'kish njeri,
tregomë përrallën deri në fund Sherazadja ime,
tregomë... tregomë se s'dua bukë, rroj me thërime,
mjafton të t'shoh me dashuri e të t'dëgjoj,
kur lehtë më flet edhe më thua: të dashuroj,
vetëm atëherë mbyll gjithë dritaret, një mbi një,
për sot mjafton, nesër s'e dimë, e shkoj e flë...

Dallëndyshe

Në gishtat e hollë, me fijet e barit, me baltëz të shkrirë,
shtegtuar thjesht, me vesë në fytyrë, me krahë të lirë,
një këngë ëndërruar, kur heshti gjithçka, kthyer iluzion,
mbi gjethe të rëna, ringritur në degë, herët apo vonë,
e zgjedh frikën time, zgjedh atje ku lind, atje ku do shkoj,
zgjedh renë ku mbështetem, erën që më shtyn, prapë të fluturoj,
mallëngjyer prej çastesh, kur jetova pak, ishte jetë e tërë,
luftë përmbi paqe, paqe përmbi luftë, shenjtërisht e bërë,
kështu qenka bota, qëkur paska lindur, e s'mund të jetë ndryshe,
ka vend për folezë, të bërë më baltë, për një dallëndyshe...

Dua të harroj

Dua të harroj, dua të çlirohem, nga kurth i kujtesës,
vjedhur nga gjithçka, nga fjalët e ëmbla, nga fjalët e besës,
vjedhur nga lumenjtë, që s'shkuan në det, por mbetën në breg,
vjedhur nga një det, ma vodhën një dallgë, e nxorën në treg,
e dua të harroj, e dua të dehem, e dua të pi,
në barin e qelbur, ku pinë kriminelët, në periferi,
të shahemi lëkundur, me nënë e me babë, me ujë e me tokë,
pa ditur çfarë themi, ashtu të përgjumur, ashtu bërë trokë,
pastaj të rinisem, mëngjesin e bardhë, të kthej dhe një tjetër,
s'është më si dikur, s'është më si njëherë, në kohë të vjetër,
kur ishim të varfër, e flinim të qetë, me derë të shpërthyer,
kur qeshnim pa frikë, kur qanim pa zë, ashtu ngashëryer,
premtanim për nesër, premtanim për sot, të bardhë si dëborë,
e emra mbi trungje, i gdhendëm ngadalë, i gdhendëm me dorë,
ndaj dua të harroj, dhashë mall për të gjithë, ku janë e ku s'janë,
shita horizontin, me diellin që fshihej, e dola matanë...